	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government Ministria e Punëve të Brendshme MinistarstvoUnutrašnjih Poslova Ministry of Internal Affairs Policia e Kosovës/Policija Kosova/Kosovo Police	
	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/ Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate	

MEMORANDUM ZYRTAR - SLUZBENI MEMORANDUM - OFFICIAL MEMORANDUM

PËR:
ZA: Prokuror në Prokurorin Speciale në Prishtinë
TO:

Data:
Datum:
Date:

PËRMES:
PREKO:
THROUGH:

Nr. i Referencës:
Br. Referencije:
Reference No:

PREJ:
OD:
FROM:

LËNDA:
PREDMET: ***KALLZIM PENAL***
SUBJECT:

Në bazë të nenit 207 paragrafi 1 dhe 2 i KPPK-së parashtroi këtë :

KALLZIM PENAL

KUNDËR :

1. Hashim REXHEPI i biri i Azizit i lindur me 05.04.1958 ne fshatin Celin KK Rahovec dhe me vendëbanim të përhershëm Rr. UÇK-së nr.17 Prishtinë nr.Personal 1004332799

2. Ibish MAZREKU i biri i Mustafës i lindur më 15/07/1969 në Prishtinë me vendbanim në Lagjen e Spitalit Prishtinë. nr. Personal 1008189877

3. Ajri BEGU i biri i Isenit i lindur më 18.03.1951 në Dibër dhe me banim të përhershëm në Lagjen Kodra e Diellit Zona Perëndimore Hyrja 9 Prishtinë nr. Personal 1019696118

4. David WEATHERMAN shtetas amerikan

5. Tom TORULLA shtetas Amerikan

6. Michel SVETCHINE

7. Stefan KOLLE i biri i Alexandrit shtetas Holandez i lindur me 16.06.1966 në Munchen të Gjermanisë dhe me vendbanim në Amsterdam të Holandës Rr. Burg.van Amsterdam nr. Personal 198818609 , nr.pasaportes holandeze N98025726

8. Hilmi HANA i biri i Islamit i lindur ne Gjakove me 17.07.1944 dhe me banim te përhershëm Lagja DARDANIA BL.6/6-2-13 Prishtine me nr personal 1015611835.

Sepse:

Ekziston dyshimi i bazuar se te dyshuarit ne bashkëveprim ne kohe te ndryshme prej vitit 2002 deri me 2007 kane kryer veprat penale :

***Detyrim sipas nenit 267 paragrafi 1dhe 2 të KPK-së**
***Kanosje sipas nenit 161 paragrafi 2 të KPK-së në lidhje me veprën penale**
***Kontraktim i fitimit jo-proporcional sipas nenit 270 të KPPK-së**
***Shpërdorim i detyrës zyrtare sipas nenit 339 te KPK-se**
***Veprimtaria e pandërgjegjshme ekonomike sipas nenit 233 te KPK-se**
***Shpëlarje e parave sipas nenit 10.2 te Rregullores se UNMIK-ut 2004/2 ne lidhje me**
*** Krim i Organizuar sipas nenit 274 te KPK-se**

ARSYETIM:

Te dyshuarit ne bashkëpunim, duke qëndruar në pozita udhëheqëse ne ish BPK tani BQK (Banka Qendrore e Kosovës) ne vite dhe kohe te caktuara prej vitit 2002 e deri me 2007 dhe duke u bazuar ne përgjegjësit e tyre, nuk kane vepruar konform rregullave dhe ligjeve të BPK-se për parandalimin e keqpërdorimeve si dhe në shumë raste kanë qenë edhe vet pjesë e këtyre keqpërdorimeve duke vepruar si një grup i organizuar kriminal për përfitime materiale për vete dhe për të tjerët si:

- Keqpërdorimet me Shoqatën e Kompanive të Sigurimeve te Kosovës për humbjen e policave kufitare si dhe keqpërdorime të tjera në lidhje me IAK (punësimin e stafit, shpenzimet e fryera, shkelja e procedurave të tenderimit etj.)
- Në rastin e falimentimit të Bankës Kreditore te Kosovës.
- Keqpërdorimin e pozitës zyrtare në rastin e BPB – së
- Shitjen e KSB dhe BRK-së, në NLB (Nova Lublanska Banka) Prishtinë**,** ku menaxheret e bankave kanë përfituar rreth **3.6 milion euro**, para këto të aksionareve te bankave KSB -së dhe BRK-së .

Keqpërdorimet në Shoqatën e Kompanive të Sigurimeve të Kosovës

Gjatë vitit 2002 janë konstatuar keqpërdorime me polica kufitare (6000 – 8000 copë) për të cilat polica, shoqata e kompanive të Sigurimeve **IAK** i ka mbajtur 40% të mjeteve për pagesën e dëmeve dhe për të cilat mjete kompanitë e sigurimeve paguajnë kamatë ATK-së.

Për këto ne ketë periudhe kane qene përgjegjës menaxhmenti i BPK-se ne krye me:
AJRI BEGU kryetar i Bordit ne BPK ,
DAVID WEATHERMAN Zv/Drejtor i Menaxhimit për Financa ne BPK ,
TOM TURULLA i cili ka qene i emëruar në cilësi të drejtorit te Sigurimeve ne BPK
STEFAN KOLLE ka qene drejtor i IAK-se dhe
HILMI HANA ka qene drejtor financiar i CIU (Fondi i Garancisë) .

* Në lidhje me dyshimin se janë keqpërdorur me mija polica dhe mjetet prej tyre janë përvetësuar, kjo është vërtetuar pasi që për këto keqpërdorime është themeluar një komision në krye me Berat BEGUN përfaqësues i BPK si dhe dy përfaqësues të kompanisë së sigurimeve ”Kosova e re”.
Komisioni në lidhje me këtë ka dal me konstatim:

- Libri i evidencës rigoroze të policave të sigurimit nuk është udhëhequr, kjo evidencë nuk është mbajtur me rregull dhe në mënyrë të duhur (është mbajtur në disa letra të thjeshta- copa letre)
- Është paraqitur bllok evidenca e ngarkesave me polica kufitare të çdo pike kufitare.
- Shënimet mbi prerjet e policave kufitare, si dhe mungesën e 9,268 copë policave kufitare.
- Vërejtja e grupit të auditorëve në teren mbi konstatimin e kopjeve të policave si të ngjashme me origjinalet (Të gjitha faqet kanë qenë pa numra) që ka bërë të mundur manipulimet e ndryshme.

Edhe pse ky raport ka qenë i bërë nga komisioni i BQK, i njëjti ka qëndruar i pa publikuar dhe është mbajtur si konfidencial duke e ditur se vlera e një police është shitur nga 150 euro deri 1500 euro që do të thotë se dëmi i shkaktuar kap vlerën nga 1,390,200 euro deri 13,902,000 euro.
Nga informatat që i kemi marrë kemi kuptuar se ekziston një llogari bankare e kësaj kohe ku edhe pse autoritetet e reja të IAK (pas rastit në fjalë) kanë tentuar të dinë për vlerën e parave në këtë llogari të deponuara deri më 2002, autoritet e BQK nuk iu kanë mundësuar qasjen me arsyetim se është ndërruar programi dhe se nuk është e mundur të hapet kjo llogari . (Raporti i auditimit të komisionit të BPK-së **prova nr. 1)**
Andaj duke u bazuar në këtë të dyshuarit:
AJRI BEGU kyetar i Bordit në BPK ,
DAVID WEATHERMAN Zv/Drejtor i Menaxhimit per Financa ne BPK ,
TOM TURULLA i cili ka qene i emëruar në cilësi të drejtorit te Sigurimeve ne BPK
STEFAN KOLLE ka qene drejtor i IAK-se dhe
HILMI HANA ka qene drejtor financiar i CIU (Fondi i Garancisë), kanë kryer në bashkëpunim me veprim apo mos veprim veprën penale .
***Shpërdorim i detyrës zyrtare sipas nenit 339 te KPK-se** në lidhje me veprën

***Krimi i Organizuar sipas nenit 274 të KPK-së** duke i sjellë vetes apo personave të tjerë përfitime të paligjshme .

Detyrimi

Sa i përket kompleksit banesor të ndërtuar në truall të kompanisë së sigurimeve Dardania nuk është vërtetuar pasi që Mehmet DUÇI pronar i kësaj kompanie e ka mohuar faktin se ky i fundit ka pasur ndonjëherë troll në Shqipëri.
Edhe pas kërkesës së drejtuar ambasadës Shqiptare në lidhje me këtë, kjo e fundit nuk më është përgjigjur.
(Në mungesë të autorizimit për zhvillimin e hetimeve ka mbetur që kjo pikë të vërtetohet në hapat e ardhshëm të hetimeve).

Shpëlarje e parave

* Në lidhje me dyshimin se H. REXHEPI është bashkëpronar me Hashmet KURUM-in, pronar i Kompanisë së sigurimeve "Kosova e re" rast I ndërlidhur me Casinot për të cilin dyshohet se nga Casinot në kompaninë e sigurimit Kosova e re janë shpërlarë 500,000 euro të cilat mjete janë deponuar në Bankën e re të Kosovës, si dhe dyshimet mbi takimet e H. REXHEPIT dhe H. KURUMIT në Shkup.

Nga certifikata e regjistrimit të kompanisë Kosova e re shihet se pronar i vetëm i kësaj kompanie është Hashmet Biidi KURUM.

Në bazë të deklaratës së dëshmitarit Visar RRUSTEMI drejtor i kompanisë së sigurimeve "Kosova e Re", se kah fundi i vitit 2007 është bërë takimi në Shkup në mes të Hashmet KURUMIT si përfaqësues i Kosovës së Re dhe Hashim REXHEPIT si përfaqësues i Bankës Qendrore ku edhe vet dëshmitari ka qenë prezent në takim. Aty është diskutuar rreth zgjedhjes së drejtorit të kompanisë Kosova e Re, pas largimit të drejtorit të atëhershëm Halit SHABANI, si dhe janë diskutuar qëllimet e Hashmet Bedii KURUM për kompaninë e sigurimeve Kosova e Re. (Për më tepër shih deklaratën e V. RRUSTEMI.)

Sa i përket transferimit të parave nga "KING CASINO" në "KOSOVA E RE" kemi transfere me datë 16.01.2006 në vlerë prej 100,000 euro, si dhe transferi tjetër është bërë më 17.03.2006 në vlerë prej 200,000 euro, pra shuma totale e këtyre transferove arrin vlerën totale prej 300,000 euro.(këto dëshmi janë nxjerrë nga kompjuterët e ekzaminuar nga rasti " STAR ")

Nga raporti i AQBK (BQK tani) të datës 15.06.2007 është vërejt përputhja e transfereve të bëra në KS " Kosova e re " me datë 17.01.2006 si dhe me datën 20.03.2006 në emër të depozitimit për rritjen e kapitalit themelor në emër të Hashmet KURUM-it e që në fakt janë para të King Casinos të pa deklaruara në ATK si qarkullim ditor. Për këto transfero ka qenë dhe është dashtë të dijë Hashim REGJEPI për shkak se në vitin 2006 (koha kur janë bërë transferet) ka qenë në pozitën e z/v Drejtorit të Përgjithshëm dhe Michel SVETCHINE i cili ka qenë në pozitën e Drejtorit Menagjues të BPK-së (BQK-së).
Prandaj duke u bazuar në këto dëshmi, ekziston dyshimi i bazuar se kemi të bëjmë me pastrim të parave duke mos deklaruar qarkullimin ditor është bërë ikje nga tatimi duke u

munduar që këto mjete ti arsyetoj si investime për depozitë për rritjen e kapitalit të KS " Kosova e re". .(**prova nr. 2**)

Meqenëse BPK është organ i autorizuar për mbikëqyrjen e ligjshmërisë dhe transferove të dyshimta dhe të njëjtat ti raportoj organeve kompetente të hetuesisë, këtë ky institucion nuk e ka bërë, ku Hashim REXHEPI ne ketë periudhe 2003 ka qene Drejtor i Mbikëqyrjes se Sigurimeve ne BPK-së, kurse ne vitin 2004 / 2005 ka qene ne postin e Zyrtarit Kryesor për Mbikëqyrje ne BPK-së . Ndërsa ne vitin 2006 dhe 2007 ka qene ne pozitën e Zv/Drejtorit te Përgjithshëm ne BPK (BQK) dhe Michel SVETCHINE ne periudhën 2006/2007 deri ne mars 2008 ka qene ne pozitën e Drejtorit Menaxhues , qe te dyte kane pas përgjegjësin për ta mbikëqyrë rrjedhën e parasë te kësaj kompanie.

Prandaj ekziston dyshimi i bazuar se Hashim REXHEPI ne bashkëpunim me Michel SVETCHINE kane kryer veprën penale **.**

***Shpërdorim i detyrës Zyrtare sipas nenit 339 te KPK-se**
***Shpëlarje e parave sipas nenit 10.2 te Rregullores se UNMIK-ut 2004/2** .në lidhje me
***Krim i Organizuar sipas nenit 274 të KPK-së**

Shpërdorimi i detyrës zyrtare

Drejtimi i i hetimeve është drejtuar në sigurimin e provave mbi dyshimin e bazuar se përmes firmës "CREA" pronë e djalit të H. Rexhepit, ku njëherit ky i fundit është drejtor i bordit drejtues të kësaj kompanie dhe pronar i 35% të aksioneve të kësaj firme. I dyshuari H. REXHEPI në emër të shërbimeve dhe përmes kësaj firme ka bërë keqpërdorimin e Shoqatës së kompanive të sigurimeve në vlerë prej 60,000 euro në emër të këtyre shërbimeve.

Nga hetimet paraprake kemi vërtetuar se ekzistojnë:

- Vendimi për blerjen e një softueri për automatizimin e proceseve të administrimit në AQBK, respektivisht në kompanitë e sigurimit dhe IAK dhe e nënshkruar nga Kryetari i Bordit të drejtorëve të IAK Fatmir GASHI.
- Transferimi i shumës 45,000 euro në konton e kompanisë CREA të nënshkruara nga Arben MIKELI, Vetima VUÇITËRNA dhe Fatmir GASHI.

Në bazë të kërkesës drejtuar Administratës Tatimore mbi të dhënat e kompanisë " CREA", deklarimet, obligimet tatimore si dhe pronarët e mundshëm të kësaj kompanie kemi mare këto rezultate:
Pronar të kompanisë CREA-KO Sh.p.k janë: Halil MAZREKU (vëllai i Ibish MAZREKUT, drejtor i drejtoratit për mbikëqyrje të kompanive të sigurimeve), Avni TRNAVA dhe Granit REXHEPI (djali i Hashim REXHEPIT, drejtor i BPK-së.
Pra, dyshimi i bazuar është vërtetuar dhe mund të themi se gjatë vitit 2007 Hashim REXHEPI ka qenë Zv/drejtor i përgjithshëm i BQK si dhe Ibish MAZREKU drejtor i sektorit për mbikëqyrje të kompanive të sigurimeve pran BQK-së kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare duke bërë të mundur kompanisë " CREA" shitjen e softuerit IAK-së në vlerë prej 45,000 euro, ku kjo paraqet konflikt direkt i interesit. **(prova nr. 3)**

Shpërdorimi detyrës zyrtare dhe konflikti i interesit.

Sa i përket drejtimit të katërt në lidhje me lëndën e cila është paraqitur në Prokurorinë Speciale në lidhje me keqpërdorimet e H. Rexhepit, ku përmendet se I ngarkuar është Prokurori Ndrecë DODAJ, për të cilën lëndë ceket se është humbur gjatë hetimeve kemi ardhur në konkluzion se:

Edhe pse në raportet e vitit 2005 dhe 2006 të BPK-së para bordit dhe para kuvendit të aksionarëve është pranuar raporti mbi auditimin si pozitiv për bankën, në shkurt të vitit 2006 është bërë një ri-inspektim nga inspektorët e BPK nën mbikëqyrjen e një eksperti të FMN- së dhe të cilët dalin me një raport krejt të ndryshëm nga ai i pari.
Ky raport paraqitet në muajin korrik të vitit 2006 me një urdhëresë administrative të BPK ku bëhet suspendimi i drejtorit, menaxherit të departamentit të kredive, si dhe një listë e aksionarëve që kryesisht kanë qenë anëtar të konzorciumit për rindërtim.

Në këtë kohë drejtorin e bordit Nazmi MUSTAFA njëherë e largojnë dhe menjëherë pas kësaj bëhet emërimi si kryetar i bordit në mënyrë që të bëjë punën rehabilituese për lëshimet që janë bërë nga menaxhmenti i mëparshëm si dhe për paraqitjen e planit për rimëkëmbje.

Pas kësaj nga ana e BPK lëshohet një urdhër ndalesë për kredi mbi 10,000 euro, e cila ka pasur si qëllim rëndimin e portfolios së kredive për shkak të gjendjes së krijuar nga kreditë e liga, dhe se kreditë mbi 10,000 euro të dhëna paraprakisht është dashur të aprovohet nga BPK-ja.

Në të njëjtën kohë duke pas parasysh gjendjen financiare (likuiditetit) të BPB-së H. REXHEPI merr kredi për vete në këtë kohë si dhe lejon dhënien e donacionit për KB " PRISHTINA " ku ai vetë është drejtor i bordit të këtij klubi.

Prandaj nga e gjithë kjo shihen lëshimet që janë bërë gjatë kontrollës së auditivit si dhe duke e ditur gjendjen e likuiditetit të BPB-së ky i fundit keqpërdor pozitën e tij zyrtare duke marrë kredi dhe duke lejuar donacion për klubin që vet ka qenë drejtor i tij.
Duke u bazuar në këto dëshmi ekziston dyshimi i bazuar se H. REXHEPI ka kryer vepër penale shpërdorim i detyrës zyrtare në lidhje me konflikt të interesit. **prova nr. 4)**

Në lidhje me dyshimet për me keqpërdorimet: Si me menaxhimin e **IAK**, shpenzimet, punësimin e punëtorëve pa konkurs, fryrje fiktive e administratës..etj. nga veprimet hetimore që janë ndërmarr kemi vërtetuar se nga 105 punëtor sa numëron IAK, 28 persona janë pranuar pa konkurs.

Duke filluar nga Hilmi HANA i cili është emëruar në këtë post, i njëjti është emëruar edhe likuidator i KS " KOSOVA si dhe likuidator i bankës Kreditore (Që në bazë të rregullores 2001/25 neni 52.4 nuk ka mundur ti mbante dy apo ma tepër vende të punës, ku ky përfitimi ka qenë mbi 10 mijë euro.)

Pastaj me emërim Sabrije AHMETI është caktuar si juriste e IAK- së e cila kishte punuar deri në atë kohë si inspektore për kontroll të kompanive të sigurimeve pran BPK-së

Emërimin tjetër e kishte bërë Ismet JASHANICËN si zëvendës të Hilmi HANËS meqenëse ai veç ishte diagnostikuar me kancer, ku pas vdekjes së tij e emëron si drejtor të fondit të garancisë me këtë rast vlen të përmendet se ky i fundit në disa dokumente zyrtare figuron edhe si drejtor i IAK/CIU-së çka paraqet shkelje të rregullores pasi që juridikisht këto dy njësi janë të ndara si subjekte juridike, veprimet e ndërmarra nga i dyshuari H. REXHEPI në emërimin e të lartcekurve në poste të caktuara(pa konkurs) paraqet keqpërdorim direkt dhe konflikt interesi.

Në listën prej 28 personave të pranuar pa konkurs gjinden edhe Haki dhe Agron NUZA (vëllezërit e gruas së Hashim REXHEPIT) Haki NUZA si drejtor i financave të CIU-së dhe likuidator i KS " Kosova" njëherë si ndihmës i Hilmi HANËS e tani si likuidator i vetëm, ku edhe njëherë shkelet rregullorja 2001/25 neni 52.4)

Pastaj Sami MAZREKU dhe Avdyl MAZREKU (vëllai i Ibish MAZREKUT dhe kushëri i tij), Venhar HANA (djali i Hilmi HANËS, ku edhe pse është refuzuar nga një anëtar i bordit ky i fundit është pranuar në punë). **(prova 5)**

Shkeljet e rregullores se BQK-se

Në bazë të Rregullores Nr2001/25 mbi licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e kompanive te sigurimit e të ndërmjetësimit në nenin 52 mbi parimet e qeverisjes BQK ka për detyrë mbikëqyrjen e zyrtarëve dhe drejtorëve për keqpërdorimin e pozitës së tyre për qëllime personale dhe vënien e masave ndëshkuese apo sipas nevojës inicimin e rasteve penale e që kjo paraqet shkelje të kësaj rregullore nga ana e autoriteteve të BQK-së si dhe neni 54 (54.2) mbi menaxhimin e kompanive të sigurimit, ky nen parasheh që çdo nëpunës i lartë i KS apo ndërmjetës i sigurimit duhet të jetë banor i Kosovës .
Nga hetimet paraprake kemi hasur që vet drejtori i IAK(Shoqata e Sigurimeve te Kosovës) është qytetar Shqiptar dhe në kohën kur është intervistuar nuk ka qenë as i lajmëruar në zyrën për të huaj ne Prishtine, kurse pozitën e drejtorit e ushtron me vite të tëra, kështu ka qenë edhe me drejtorin e KS SIGAL **(prova nr. 6)**

Dyshime për Korrupcion

Letra anonime e marrë nga AKK-ja (Agjencioni Kunder Korrupcionit) edhe pse nuk është në kronologji të mirë mund të vërehen metoda e njëjtë (modus oparandi) si tek BpB - ja, pasi që në raportet e BPK mbi afarizmin e bankës Kreditore kanë qenë të vlerësuara gjatë vitit 2004 me nota të larta (prezantim i rrejshëm i gjendjes faktike) dhe më pastaj nga ana e auditorëve ndërkombëtar është konstatuar gjendja jo e mirë e bankës kreditore dhe me kërkesë të BPK-së është kërkuar likuidimi (e jo nga anëtarët e bordit) pasi që ata për shkak të gjendjes së krijuar në bankë e kanë humbur legjitimitetin me punën e tyre jo profesionale, ku pjesa dërmuese duke përfituar në mënyrë të pa ligjshme kanë marrë kredi në vlera mbi vlerën e aksioneve që i kanë pasur në këtë bankë. Pra, të gjithë anëtarët e bordit janë të implikuar pasi që këta të fundit të gjitha këto kredi i kanë aprovuar.
Nga BPK janë caktuar dy likuidator Michael ROUZWEL likuidator ndërkombëtar i cili vlerësohet nga shkruesi i letrës si i pa suksesshëm, pas tij caktohet Hilmi HANA si likuidator i cili tregohet si jo i suksesshëm pasi që ky i fundit asnjëherë nuk ka punuar në asnjë bankë, por ka punuar në kompani të sigurimeve (në shoqatën e kompanive të

sigurimit, gjegjësisht në fondin e garancisë dhe njëherit është edhe likuidator i KS "KOSOVA")
Meqë administratori është dashur të largohet për 6 muaj për shkak të punës jo efikase dhe jo profesionale dhe për të mbuluar këtë mos sukses i angazhon njerëz jo profesional të propozuar nga ish bordi dhe të preferuar edhe nga ana e Hashim Rexhepit me qëllim të mbështetjes së bordit të mëhershëm gjegjësisht debitorëve kryesor të kësaj banke.
Të njëjtit persona në bazë të letrës anonime bartin përgjegjësi për prezantim të gjendjes faktike me raportet e tyre dërguar në BPK.
Këta zyrtar të angazhuar nga likuidatori kanë kryer këto punë dhe detyra:
Pashk MIRASHI drejtor i filialit në Gjakovë, Bajram MALOKU kontrollor i brendshëm, Sami IBISHi drejtor financiar, Nexhat XHARRA përfaqësues.
Nga informatat që i kemi një ekip ndërkombëtar është duke e hetuar rastin në fjalë dhe nëse konfirmohet kjo këto materiale do i përcillen, në të kundërtën pasi të ndërmerret aktvendimi për hetime nga ana e prokurorisë, mbetet që veprimet tjera të ndërmerren nga njësia e jonë ku do njoftoheni me kohë **(prova nr. 7)**